

VENDIM
Nr. 22, datë 21.3.2014

**PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES TË SHOQËRISË “MTC ENERGY” SHPK NGA
HEC “RADOVË”**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “l”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 3, pika 1, germa “f”, të ligjit nr. 138/2013, datë 2.2.2013 “Për burimet e energjisë së rinovueshme”, të nenit 9, pikat 1 dhe 2, germa “a”, të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 21.3.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “MTC Energy” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për HEC “Radovë”, si burim i rinovueshëm energjie, konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “MTC Energy” sh.p.k., është konform “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të kualifikojë impiantin prodhues të shoqërisë “MTC Energy” sh.p.k. nga HEC “Radovë”, si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti